



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS**  
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

	Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosovo	
	KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS SUDSKI SAVET KOSOVA KOSOVO JUDICIAL COUNCIL	
Nr. Bf. No.	01 / 380	
Data Dt.	12. 04. 2023	
	PRISHTINË - A	

**KGJK. Nr. 147/2023**

**Datë: 6 prill 2023**

**KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS (KGJK)**, në bazë të nenit 108, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenit 7, paragraf 1, pika 1.14, të Ligjit Nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe nenit 9, par.1, pika 1.3, të Ligjit 06/L-057 Për Përgjegjësin Disiplinore të Gjyqtareve dhe Prokuroreve, duke vendosur në ankesën disiplinore të ndaj vendimit GJS-2023-002, të Autoritetit Kompetent/ushtreses së detyrës së Kryetares së Gjykatës Supreme të Kosovës znj. Mejreme Mema, në mbledhjen e 307-të, të mbajtur me datë 6 prill 2023, nxjerr këtë:

## V E N D I M

**Hudhet si e pa lejuar** ankesa e [ ] e paraqitur kundër vendimit GJS-2023-002, të datës 28.02.2023, të nxjerr nga Ushtresja e detyrës së Kryetares së Gjykatës Supreme të Kosovës

## A r s y e t i m

Këshilli Gjyqësor i Kosovës, ka pranuar ankesën/kërkesë nga [ ] nga Peja për fillimin e hetimeve për dyshime për shkelje disiplinore të Mejreme Mema, ushtrese e detyrës së Kryetares së Gjykatës Supreme të Kosovës me rastin e nxjerrjes së vendimit GJS-2023-002, me të cilën është refuzuar ankesa e paraqitur nga [ ] ndaj Kryetarit të Gjykatës Themelore në Pejë z. [ ] dhe Nënkyetares së kësaj Gjykate, :

Ankuesi në këtë çështje disiplinore pretendon se ushtresja e detyrës së Kryetarit të Gjykatës Supreme znj. Mejreme Memaj me nxjerrjen e aktvendimit të saj të evidentuar GJS-2023-002, të datës 28.02.2023, duke përdorur potencialin e saj, ka tentuar të ndryshoj dispozitat ligjore të Ligjit 06/L-057 Për Përgjegjësin Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokuroreve dhe të ligjit për gjykata.

Këshilli Gjyqësor i Kosovës, në mbledhjen e mbajtur me datë 6 prill 2023, pasi e shqyrtoi dhe vlerësoj pretendimet ankimore të vendimit të ankimuar, në mbështetje të nenit 9, paragrafi 6 dhe 7, të Ligjit 06/L-057 Për Përgjegjësin Disiplinore të Gjyqtareve dhe Prokuroreve, ka gjetur se:

Ankesa e [ ] kundër vendimit GJS-2023-002, të datës 28.02.2023, të nxjerr nga ushtresja e detyrës së Kryetares së Gjykatës Supreme të Kosovës, është e pa lejuar.

Në këtë drejtim, Ligji 06/L-057 Për Përgjegjësin Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, i ka dhënë mundësin secilit person fizik dhe juridik që të parashtror ankesë ndaj një gjyqtari tek Autoriteti Kompetent apo të Avokati i Popullit, i cili duhet qe ankesën ta përcjell tek Autoriteti Kompetent, mirëpo nuk ja ka dhanë mundësinë ligjore personave fizik dhe juridik që të parashtror ankesë ndaj vendimit të Autoritetit Kompetent tek Këshilli kur Autoriteti Kompetent e ka refuzuar ankesën disiplinore, sepse për këtë veprim është i autorizuar vetëm Avokati i Popullit.

Në këto rrethana, Këshilli duke vlerësuar ankesën e parashtruar se bashku me shkresat e bashkuara sa i përket pretendimeve ndaj vendimit GJS-2023-002, të datës 28.02.2023, të nxjerr nga Autoriteti Kompetente përkatësisht ushtruesja e detyrës së Kryetares se Gjykatës Supreme të Kosovës znj. Mejreme Mema, konstatoj qe ankesa **është e pa lejuar**.

Nga se u tha me lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshilli Gjyqësor i Kosovës  
KGJK.nr.147/2023, datë: 6 prill 2023

Albert ZOGAJ,

Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës



*Kopje e vendimit i dërgohet:*

- ankuesja në këtë rast;
- Mejreme Memaj, ushtruese e detyrës së Kryetares, Gjykata Supreme e Kosovës;